



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO - REPUBLIC OF KOSOVO

GJYKATA KUSHTETUESE

USTAVNI SUD

CONSTITUTIONAL COURT

SEKRETARIA / SEKRETARIJAT / SECRETARIAT

Prishtinë, më 7 shtator 2023

Në mbështetje të nenit 12 të Ligjit nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës; në mbështetje të rregullit 17 të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës nr. 01/2023; si dhe në mbështetje të Rregullores nr. 06/2022 për ndryshimin dhe plotësimin e Rregullores nr. 02/2022 për punën praktike në Gjykatën Kushtetuese, me qëllim të edukimit profesional në fushën juridike të gjyqimit dhe të interpretimit kushtetues, Sekretariati i Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës shpall publikisht

### **SHPREHJEN E INTERESIT për angazhimin e praktikantëve**

**Pozita:** Praktikant

**Numri i pozitave:** 6 (gjashtë)

**Kohëzgjatja e praktikës:** Një (1) vit

#### **Detyrat kryesore**

- Detyrat kryesore të punës së praktikantit janë si në vijim:
  - angazhohet në punën e këshilltarëve kushtetues juridik dhe të gjyqtarëve;
  - mbledh dhe studion literaturë përkatëse ligjore, informacione dhe dokumente sipas kërkesës nga këshilltarët ligjor dhe nga gjyqtarët;
  - përgatit analiza krahasuese nën udhëheqjen e këshilltarëve kushtetues juridik;
  - hulumton praktikat dhe vendimet e gjykatave tjera kushtetuese dhe ato të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut;
  - mirëmban dhe përditëson shënimet përkatëse të databazave të Gjykatës;
  - përkujdeset për fajllimin e dokumentacionit përkatës, skenimit, fotokopjimit të materialeve të nevojshme sipas kërkesës; dhe
  - kryen punë të tjera profesionale sipas kërkesës së Kryetarit, Këshilltarit të Parë apo Gjyqtarëve, apo Mbikëqyrësit të praktikantëve.

#### **Kualifikimet dhe aftësitë**

- Të drejtë aplikimi për pozitën e praktikantit kanë të gjithë kandidatët që
  - të janë shtetas të Republikës së Kosovës;
  - kanë zotësi të plotë për të vepruar;
  - zotërojnë njërën nga gjuhët zyrtare në Kosovë si dhe kanë njohuri të shkëlqyeshme të gjuhës angleze;

- iv. kanë diplomuar në fakultetin juridik në njërin nga universitetet në Kosovë, kanë diplomë të fakultetit juridik të nostrifikuar në Kosovë, ose janë në vitin e fundit të studimeve në fakultetin juridik; dhe
- v. demonstrojnë shkathtësi solide kompjuterike.

### **Informata të përgjithshme për kandidatët**

Shuma e kompensimit material të praktikantëve do të jetë ekuivalente me pagën minimale në Republikës e Kosovës në vitin e angazhimit të praktikantit;

Para kalimit të afatit kohor për të cilin janë pranuar në Gjykatë, praktikantët i nënshtrohen vlerësimit të njohurive të fituara gjatë punës praktike.

Pas përfundimit të periudhës vlerësuese, praktikanti pajiset me certifikatë me të cilën dëshmohet kryerja e suksesshme e punës praktike në Gjykatë.

Gjykata ofron mundësi të barabarta të angazhimit për gjithë kandidatët aplikues.

### **Procedura e konkurrimit**

Kandidatët e interesuar duhet të paraqesin aplikacionin përkatës të Gjykatës, të shoqëruar nga një biografi profesionale, një letër motivuese dhe dokumentacionin përkatës për përgatitjen shkollore. Forma e aplikacionit mund të shkarkohet nga ueb-faqja e Gjykatës Kushtetuese: [www.gjk-ks.org](http://www.gjk-ks.org)

Aplikacioni, me të gjitha dokumentet, duhet të paraqitet nëpërmjet e-mailit, në adresën: <mailto:gjk.burimetnjerezore@gjk-ks.org>

Konkursi mbetet i hapur 15 (pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit në ueb-faqen e Gjykatës dhe në tabelën e shpalljeve, duke filluar nga data 07/09/2023 deri më datën 21/09/2023, që konsiderohet ditë e fundit e mbylljes së konkursit.

**Data e fundit për pranimin e aplikacioneve është 21 shtator 2023, deri në ora 16.00.**

### **Shënim:**

Aplikacionet që arrijnë pas afatit dhe ato të pakompletuara nuk do të shqyrtohen.